

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.09.2024*

18.09.2024

Ora, 12:32

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Madalena Koja

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, në orën 12:30. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të KQZ-së, përfaqësues të shoqërisë civile. Në mbledhjen e sotme kemi në rendin e ditës projektvendimin “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes që kemi në rendin e ditës, dëshiroj të pyes kolegët, nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për t’i trajtuar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.09.2024*

dhe vendosim rradhën nëse do të kenë. Kolegë? Nuk ka! Fillojmë me këtë projektvendim. Zonja Koja, ju lutem një përmbledhje të projektaktit dhe relacionit.

Znj. M. Koja: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator! Zonja Nano, përshëndetje! Referuar nenit 167, të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve shpallet nga KQZ-ja, jo më vonë se 5 ditë nga data e shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore dhe pasi të kenë përfunduar procedurat e ankimit. Më lejoni të parashtroj si vijon, ecurinë e vendimmarrjeve të deri tanishme, që kanë paraprirë vendimmarrjen e sotme të Komisionit Rregullator. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, me vendimin nr. 85, datë 5.8.2024, ka shpallur fitues zotin Vangjel Llambi Tavo, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Kundër vendimit të KZAZ është depozituar në KAS, kërkesa ankimore me nr. 11 nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt: Kundërshtimin e vendimit nr. 85, të KZAZ nr. 88 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Himarë”. Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha QV e kësaj KZAZ-je, si dhe rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve për Bashkinë Himarë. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, pasi shqyrtoi çështjen, me vendimin nr. 19, datë 26.8.2024 vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 85, të KZAZ nr. 88. Kundër këtij vendimit janë depozituar dy kërkesë padi pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me vendimin nr. 5, datë 9.09.2024 vendosi unanimisht, rrëzimin e padisë së palës paditëse Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”. Në vijim Komisionieri me vendimin nr. 177, datë 12.09.2024 i dha mandatin e kryetarit të Bashkisë Himarë, zotit Vangjel Llambi Tavo. Komisioni

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.09.2024*

Rregullator, pas dhënies së mandatit nga Komisioneri në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “d” dhe nenit 167 të Kodit Zgjedhor, shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Për sa më sipër të referuar, keni bashkëlidhur projektvendimin për shqyrtim dhe miratim nga ana juaj, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Koja! Fillojmë atëherë me shqyrtimin në parim të projektvendimit. Ka diçka për të diskutuar nga kolegët në parim? Nuk ka! Kalojmë në votimin në parim!

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Miratohet në parim!

Kalojmë me leximin dhe miratimin sipas pikave të projektvendimit.

Znj. H. Vukaj: Mundem zonja Nano!?

Znj. I. Nano: Po, po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Faleminderit! Përpara se të kalojmë në votimin pikë për pikë të këtij projektakti do të doja për transparencë të qytetarëve të Bashkisë Himarë kryesisht, të tregoja dhe njëherë ecurinë procesuale ligjore dhe garancitë e këtij procesi të cilat në ndërgjegjen dhe moralin e anës profesionale, etike që përfaqësoj dhe në respektim të garancive që Kushtetuta garanton për votuesin, nuk ishin në pritshmëritë e duhura. Unë do të kisha kënaqësinë të votoja këtë akt sot dhe të uronim me certifikimin gjithpërfshirës, zotit Tavo Suksese, por duke qenë se ky akt vjen si pasojë e një procesi i cili, jo vetëm nuk garantoj, por shënjoj paligjshmëri që në aktin e parë i cili

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.09.2024*

rrëmbeu haptazi kompetencat e Këshillit të Ministrave. Më pas vijoi me procese të cilat identifikuan siç ishte raporti teknikien i auditit, identifikuan handikape, mangësi, parregullsi, të cilat çonin dhe çuan drejt mohimit të votës së mijra zgjedhësve. Atëherë, duke qenë se jemi në kushtet e pasigurisë juridike të përmbylljes dhe votës pro, ose certifikimit nga ana ime të këtij procesi, unë zgjedh t'i rri strikt anës sime dhe të respektoj kodin dhe kushtetutën deri në fund me integritet dhe votë të barabartë për të gjithë. Pra, vota është e shenjtë dhe si e tillë duhet respektuar në mënyrë të barabartë për të gjithë votuesit, për të gjithë zgjedhësit. Ç'ka në këtë proces nuk u përmbush e nuk u garantua as nga ky institucion dhe as nga hallka të tjera ndërvepruese, bashkëpunuese të cilat duhet të kishin të njejtin sensibilitet. Për këtë arsye unë shpreh votën time kundra, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Po zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Faleminderit e nderuar! Ashtu siç ne e kemi diskutuar që në nisje të procesit të zgjedhjeve të pjesshme në Himarë, për kryetar bashkie, rezultoi më pas gjatë gjithë procesit, por edhe pas përfundimit të procesit të votimit, se e gjitha ajo çfarë ne denoncuam, bëmë me dije, informuam publikun, rezultoi të materializohej në këtë proces zgjedhor. Unë me keqardhje konstatoj se ky proces zgjedhor ishte një proces i dështuar. Ishte i dështuar së pari, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe sigurisht ishte i dështuar për të gjithë Shqipërinë. Nga ana tjetër, unë i bëj thirrje, qoftë organeve të tjera drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi na presin sfida të mëdha përpara siç është vota e diasporës, por dhe zgjedhjet e përgjithshme të prill-maj 2025, që të angazhohen maksimalisht e të ndërmarrin të gjithë hapat ligjorë, të venë të gjitha forcat në mënyrë që zgjedhjet e vitit 2025 mos të jenë si

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.09.2024*

zgjedhjet e Himarës. Nuk dua që zgjedhjet e dështuara të Himarës të jenë preludi i zgjedhjeve të vitit 2025. Me keqardhje konstatoj që mund të jemi në atë rrugë. Zgjedhjet nuk vidhen në rutinë e numërimit, zgjedhjet nuk vidhen në javën e numërimit. Zgjedhjet vidhen, manipulohen sot, javën që vjen, muajin që vjen. Javët dhe muajt në vijim do të duhet që të ndërgjegjësojnë gjithë palët dhe do të duhet ti japin besim reciprok njëri-tjetrit dhe shqiptarëve që të kemi zgjedhje të lira dhe të ndershme. Pikërisht për këto arsye edhe vota ime është kundra në parim të këtij akti dhe sigurisht kundra dhe në tërësi. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj, para se të kalojmë në votimin pikë për pikë, me lejoni dhe mua dy fjalë, pa rënë në përsëritje të atyre ç'ka u relatuan nga ana e zonjës Koja. Gjithsesi do të doja të thoja se vendimmarrja jonë e sotme, ose akti që ne jemi duke shqyrtuar dhe kemi votuar në këtë moment në parim, është rezultante e një procesi që nisi në datën 4 gusht me votimin, në datën 5 gusht me vendimmarrjen e KZAZ-së. Më tej kemi proceset ankimore sikundër u relatuan qoftë në Komisionin e Ankimeve e Sanksioneve, ashtu dhe në Kolegjin Zgjedhor dhe deri në aktin pararendës që është dhënia e mandatit nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për fituesin e këtyre zgjedhjeve. Në këtë moment ne shpallim një rezultat tashmë të certifikuar. Nëse nuk ka diçka tjetër, kalojmë në shqyrtimin pikë për pikë. Pra, Komisioni Rregullator vendosi:


1. Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, si më poshtë:

a) Zoti Vangjel Llambi Tavo, kandidat fitues për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Kalojmë në votimin e pikës 1,

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.09.2024*

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Me tre vota pro e dy kundër miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Me tre vota pro e dy kundër miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Miratohet pika 3.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, edhe një herë kolegë,

Kush është dakord me projektvendimin?

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Me tre vota pro e dy kundër kemi miratuar vendimin “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”.

Meqënëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës, apo jashtë rendit të ditës për të shqyrtuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 08

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

